

PRAVILIKANË KOMUNITETI I KOSOVES

KOSOVA/KOMUNITETI/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO/  
OSNOVNI SUD U MITROVICI/GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE/OSNOVNI SUD U MITROVICI /BASIC COURT IN MITROVICA

A

2013/000000000000000000

C.nr. 57/2012

DOKUMENTI NUMERO 57/2012/GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne  
deshitet i juri<sup>d</sup>ike te paditse; nga te cilen e perfaqson  
Avokat, nga sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures;  
nGA , tani me vendbanim te panjohur te cilen e perfaqson  
Perfaquesi i perkoshem, Avokat , nga , sipas aktvendimit te  
kesaje gjykate, baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e kontestit; 800,00 Euro, pase  
mbaltjes se shqyrtimit kryesor te dt.21.11.2013, jep kete;

### A K T G J Y K I M

I- APROVOHET kerkespadia e paditsese; nga dhe  
VERTETOHET se paditesja eshte pronare e palujtshmeris, parc.kat. me  
kultur, shtipi me siperfaqe prej **0.00.53 ha** si dhe shfrytuese e perhersheme e oborrit me  
siperfaqe prej **0.05.00 ha**, kullo e kl.-5 me siperfaqe **0.01.29 ha** ne vendin e qijtur  
“ ”, sipas qertifikates se pronesise nr. ZK- , e qe evidentohet ne emer te  
paditurese; [ ], 1/1.

II- DETYROHET e paditura qe ti njohi kete te drejte paditsese dhe ti lejoje qe  
paditesja kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te saje prane Drejtorese per Kataster  
dhe Gjeodezi ne , ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije  
aktgjykimi.

-Sicila pale i barте shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

### A r s y e t i m

Paditesja ne padi si dhe nepermjet te autorizuarit te saje ne seancat e mbajtura  
ka blersuar se e njejt para 30 viteve e ka blere palujtshmerin kontestuese dhe nga  
momenti i shitblerjes paditesja sbashku me familjet e tyre kane hyre ne posedim te  
prones; ku ne vazhdimesi e kane shfrytuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesja  
tani voni ka kuptuar qe palujtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te saje qe nga blerja  
e saje nuk evidentohet ne emrin e saje, andaj ka interes juridik qe kjo palujtshmeri edhe  
juridikisht te evidentohet ne emerin es aje. Pasi qe e paditura eshte ne adrese te panjohur i  
propozone gjykates qe te njejtes ti caktoj perfaquesin e perkoshem.

I autorizuari i paditese ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar nga se paditesja kete palujtshmeri e ka fituar ne baze te mbajtjes me mirbesim.

#### Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditeses e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr.57/2012 dt. 22.10.2013 te paditures i caktoje Perfaqsuesin e perkohshem, Avokat nga i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Perfaqsuesi i perkohshem i te paditures ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditsese ne fjalen perfundimtare i propozoj gjykates qe te sjell vendim meritor ne pajtim me dispozitat ligjore

Shpenzimet e perocedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojslime dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vodosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexi; Certifikatat mbi pronesin, nr. dt27.09.2013, lexi ekspertzen gjeodete te ekspertit gjeode, te dt.11.11.2013, beri veshtrimin ne Kopjen e Planit, Procesverbalin mbi kqyrjen ne vend te kesaj gjykate C. nr.57/2012 dt 08.11.2013 ndegjoi deshmitaret; dhe  
dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Qertifikata mbi te drejtat e prones se palujtshme te cekur me larte konstatohet se parc. kat. tani lendore evidentohen ne emer te paditures, sikurse qe eshte cekur ne dispozitiv te aktgjykimit.

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te palujtshmerise nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posdon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne , eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese bine -gjegjesishte e perbene parc. e cekur me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe Kopjen e planit te cilat jane pjesa perberse te kesaje ekspertize dhe te aprovar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga Procesverbalit mbi kqyrjen ne vend i kesaje gjykate, Gjyqtari me vrojtim te drejperdrejt konstaton se kjo palujtshmeri eshte e perkufizuar ne pjesen e eperme me tela dhe ne te gjendet 1- verande dhe ne pjesen e poshtme kufizohet me lumin –

Deshmitari . . . . . deklaroi; pasi qe vajzen e . . . . . e ka re , mire i kujtohet fakti se . . . . . diku para 33-4 viteve e ka blere diku 6-ari truall ku ka qen 1- shteti e vjeter perdhese me 2- dhoma; mirepo gjate luftes eshte demtuar dhe shkatruar. Qmimi i shitblerjes nuk i kujtohet mirpo . . . . . me antar te familjes e ka shfrytzuar pa kurfar pengese nga askush. Nga . . . . . ajo ka dal ne Gjermani me familje ku ende gjendet atje duke qendruar .

Deshmitari . . . . . deklaroi; e di mir qe . . . . . qysh para 30. viteve e pate blere nga 1-Serbe , truallin sbashku me 1- shteti perdhese te vjeter me 2- dhoma. Diku kan qen 5-6 ari. Qmimi ka qene diku [2.000-3.000] DM,dhe ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe menjehet ka hy ne shfrytzim te papengushem deri ne fillim te luftes ne Kosove.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore paditesja; e ka blere nga shitesja sipas marrveshjes gojore mbi shitblerjen qysh para 30- viteve me qmim te shitblerjes prej [2.000-3.000]DM, te cilin qmim ne tersi ia ka paguar shitsese e cilia menjehet i ka lene ne disponim dhe shfrytzim te lire kete palujtshneri paditeses e cila kete palujtshmeri e ka shfrytzuar pa kurfar pengese nga shitblerja e gjer ne fillimin e Luftes ne Kosove ne vit 1999, ku e njejtta tani gjendet me qendrim me familje ne Gjermani.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderper nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes , paditesja e ka pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri tani lendore dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditsese ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i kesaje palujtshmerie.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditsja kete palujtshmeri e ka blere nga pronarja e saje qka vertetohet nga fleta poseduse ne emer te paditures.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesja kete palujtshmeri e ka blere qysh para 30- viteve .

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesja ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie gjer me tani. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronsise nga ana e paditeses me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

4.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen.  
450 dhe 459 te LPK.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**C.nr.57/2012 dt. 21.11.2013.**

**G j y q t a r i,**  
Ragip Kadriu,

**KESHILLE JURDIKE;** Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankesa ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine e permes kesaje gjykate.